FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 153

Tiranë – E premte, 26 tetor 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 207, datë 27.9.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Albgaz" sh.a., mbi miratimin paraprak të zyrtarit të përputhshmërisë së OST-së të Gazit Natyror.....	10211
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 208, datë 27.9.2018	Mbi fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë "SA'GA MAT" sh.p.k., nr. 247, seria PV14K, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 92, datë 16.10.2014, për prodhimin e energjisë elektrike, nga HEC-et: "Germani 1", me fuqi 1200 kw; "Germani 2", me fuqi 1680 kw; "Germani 3", me fuqi 1290 kw, "Germani 4", me fuqi 810 kw, me fuqi totale 4980 kw.....	10212
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 209, datë 27.9.2018	Mbi licencimin e shoqërisë AEE sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Plug", me fuqi të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Bashkinë Lushnjë, qarku Fier.....	10213
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 210, datë 27.9.2018	Mbi licencimin e shoqërisë AEE sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	10214
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 211, datë 27.9.2018	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "BE-IS Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: "Kalivarë 1", me fuqi të instaluar 578 kw; "Kalivarë 2", me fuqi të instaluar 1234 kw; "Kalivarë 3", me fuqi të instaluar 1653 kw, dhe "Kalivarë 4", me fuqi të instaluar 1998 kw, me fuqi totale 5463 kw, me vendndodhje në Bashkinë Pukë.....	10215
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 212, datë 27.9.2018	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "DON-UCD" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	10216

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 213, datë 27.9.2018	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin shtator 2018.....	10217
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 214, datë 11.10.2018	Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe të Shkëmbimit të të Dhënave.....	10219
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 215, datë 11.10.2018	Mbi transferimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike me nr. 251, me seri P14FPP, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, e vlefshme deri në datën 27.10.2019, dhe të detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë "Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike" sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016, te shoqëria "Furnizuesi i shërbimit universal" sh.a. (FSHU sh.a.).....	10242
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 216, datë 11.10.2018	Mbi transferimin e licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë "Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike" sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, te shoqëria "Operatori i sistemit të shpërndarjes" sh.a. (OSSH sh.a.), e vlefshme deri në datën 27.10.2044.....	10244
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 217, datë 11.10.2018	Mbi kërkesën e shoqërisë "Danske Commodities Albania" sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, për ndryshimin e ortakut të vetëm të shoqërisë "Danske Commodities A/S", me 100% të kuotave të kapitalit, nëpërmjet shitjes.....	10246
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 218, datë 11.10.2018	Mbi rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 133, datë 7.6.2018, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Çaushi-Energji' sh.p.k., për modifikimin e licencës së "Prodhimit të energjisë elektrike" nr. 181, seria PV12K, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 122, datë 29.8.2012".....	10246
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 219, datë 11.10.2018	Mbi licencimin e shoqërisë "DON-UCD" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	10248
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 220, datë 11.10.2018	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Ener Trade" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	10248
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 221, datë 11.10.2018	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Ener Trade" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	10249
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 223, datë 16.10.2018	Mbi miratimin e "Kërkesave minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale, si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse" dhe miratimin paraprak të zyrtarit të përputhshmërisë së OST të Gazit Natyror.....	10250
	Vendim *(i shkurtuar)* për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ferdinant Mihaj.....	10251
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Kujtim Belegu.....	10251

VENDIM
Nr. 207, datë 27.9.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "ALBGAZ" SHA, MBI MIRATIMIN PARAPRAK TË ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË OST-së TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 47, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror"; të nenit 19, pika 1, të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s "Mbi certifikimin e shoqërisë operatori i kombinuar i gazit natyror 'Albgaz' sh.a.", Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Albgaz" sh.a., mbi miratimin paraprak të zyrtarit të përputhshmërisë së OST-së të gazit natyror,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, ka certifikuar "Operatorin e kombinuar të gazit natyror 'Albgaz' sh.a.".

- Shoqëria "Albgaz" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 565 prot., datë 3.9.2018, ka paraqitur kërkesën për miratimin paraprak të kandidaturës së zyrtarit të përputhshmërisë.

- Shoqëria "Albgaz" sh.a. duhet të paraqesë për miratim në ERE, "Kërkesat minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale, si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse", detyrim i cili buron nga "Programi i përputhshmërisë", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.5.2017.

- ERE ka miratuar kontratën e zyrtarit të përputhshmërisë, sipas nenit 47 të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 78, datë 26.5.2017.

- Konform nenit 47, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", OST-ja krijon një program të përputhshmërisë, në të cilin përcaktohen masat e nevojshme për garantimin e sjelljes jodiskriminuese, i cili miratohet nga ERE, si dhe metodën për monitorimin e përputhshmërisë me këtë program. Programi i përputhshmërisë përcakton detyrimet e veçanta për të punësuarit e OST-së, me qëllim plotësimin e këtyre objektivave. Përputhshmëria me programin monitorohet në mënyrë të pavarur nga një zyrtar i përputhshmërisë.

- Kontrata e zyrtarit të përputhshmërisë, në nenin 2.1 të saj përcakton, se: "Zyrtari i përputhshmërisë duhet të përmbushë kërkesat minimale për kriteret profesionale dhe kriteret e tjera përzgjedhëse të vendosura nga OST-ja [organi përkatës] dhe miratohen nga ERE dhe që janë zbatuar për përzgjedhjen e zyrtarit të përputhshmërisë. Zyrtari i përputhshmërisë duhet të plotësojë kriteret profesionale dhe kriteret e tjera përzgjedhëse gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës. Kriteret profesionale dhe kriteret e tjera përzgjedhëse, të vendosura nga OST-ja [organi përkatës] dhe të miratuara nga ERE, duhet të bashkëngjiten në [shtojcën II] të kësaj kontrate".

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Albgaz" sh.a., për miratimin paraprak të zyrtarit të përputhshmërisë së OST-së së gazit natyror.

2. Shoqëria "Albgaz" sh.a. të paraqesë në ERE për miratim "Kërkesat minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale, si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse".

3. Shoqëria "Albgaz" sh.a. të informojë ERE-n dhe Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë në vijimësi, lidhur me kërkesat e pikës 73 (raportimi për zbatimin e programit) të "Programit të përputhshmërisë të operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.5.2017.

4. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë "Albgaz" sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 208, datë 27.9.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "SA'GA MAT" SHPK, NR. 247, SERIA PV14K, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 92, DATË 16.10.2014, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC-et: "GERMANI 1", ME FUQI 1200 kw; "GERMANI 2", ME FUQI 1680 kw; "GERMANI 3", ME FUQI 1290 kw, "GERMANI 4", ME FUQI 810 kw, ME FUQI TOTALE 4980 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 10, pika 3 dhe të nenit 15, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 15 dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 27.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë "SA'GA MAT" sh.p.k., nr. 247, seria PV14K, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 92, datë 16.10.2014, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: "Germani 1", me fuqi 1200 kw; "Germani 2", me fuqi 1680 kw; "Germani 3", me fuqi 1290 kw; "Germani 4", me fuqi 810 kw, me fuqi totale 4980 kw,

konstatoi se:

- Shoqëria "SA'GA MAT" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 567, datë 3.9.2018, ka kërkuar modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria "SA'GA MAT" sh.p.k. është mbajtëse e licencës me nr. 247, seria PV14K, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: "Germani 1", me fuqi 1200 kw; "Germani 2", me fuqi 1680 kw; "Germani 3", me fuqi 1290 kw; "Germani 4", me fuqi 810 kw, me fuqi totale 4980 kw, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 92, datë 6.10.2014.

- Kërkesa për modifikimin e licencës së sipërcituar vjen si rezultat i optimizimit të skemës hidroenergjetike, si dhe për përmirësimin e të gjithë parametrave, duke pakësuar numrin e HEC-eve në 2, me ndërtimin e objektit konkret "Germani 1" dhe "Germani 2".

- MIE, me shkresën nr. 415/12 prot., datë 27.4.2017, drejtuar shoqërisë "SA'GA MAT" sh.p.k., për dijeni AKBN-së, ka miratuar projektin e zbatimit përfundimtar, të ndryshuar të HEC-eve "Germani 1" dhe "Germani 2".

- Në vijim të sa më sipër, shoqëria "SA'GA MAT" sh.p.k. dhe MIE kanë lidhur kontratën shtesë të koncesionit me nr. 618 rep. dhe nr. 203 kol., datë 13.6.2017, "Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (ndërtim operim, transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve: "Germani 1", "Germani 2", "Germani 3", "Germani 4" dhe "Germani 5".

- Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria "SA'GA MAT" sh.p.k., në bazë të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", rezulton i plotësuar pjesërisht si më poshtë:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Neni 9, pika 1:

- Germa "a" (të dhënat për aplikim): plotësuar;
- Germa "b" (të dhëna identifikuese për aplikuesit): plotësuar;
- Germa "c" (të dhëna për aplikuesin): plotësuar.

Neni 15 pika 4:

- Germa "a", një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës: plotësuar;
- Germa "b", vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilët shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës, vendimi i datës 31.8.2018: plotësuar;
- Germa "c", miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjerë të licencës kur këta janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera: plotësuar pjesërisht. Është depozituar në ERE nga subjekti, shkresa e MIE-s nr. 415/12, datë 27.4.2017, "Miratohet projekti i zbatimit i ndryshuar, i HEC-eve "Germani 1" dhe

"Germani 2", si dhe kontrata shtesë e koncesionit me nr. 618 rep., nr. 203 kol., datë 13.6.2017, e lidhur midis MIE dhe "SA'GA MAT" sh.p.k., në vijim të miratimit, por nuk janë depozituar të rifreskuara "Leja mjedisore", "Leja e përdorimit të ujërave", si dhe miratimi i OST-së pas ndryshimeve që ka sjellë ndryshimi i projektit të zbatimit dhe shtesa në kontratën e koncesionit të sipërcituar;

- Germa "d", ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit, sipas legjislacionit në fuqi: plotësuar;

- Germa "e", të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE: plotësuar.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

- Miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjerë të licencës kur këta janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera (neni 15, pika 4, germa "c") do të njoftohet subjekti që t'i paraqesë ata brenda afateve që përcakton "Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike",

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë "SA'GA MAT" sh.p.k., nr. 247, seria PV14K, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 92, datë 16.10.2014, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: "Germani 1", me fuqi 1200 kw; "Germani 2", me fuqi 1680 kw; "Germani 3", me fuqi 1290 kw; "Germani 4", me fuqi 810 kw; me fuqi totale 4980 kw. Modifikimet do të rezultojnë si më poshtë:

- Kudo në licencë ku shprehet "hidrocentralet 'Germani 1', me fuqi të instaluar 1200 kw, 'Germani 2', me fuqi të instaluar 1680 kw; 'Germani 3', me fuqi të instaluar 1290 kw; 'Germani 4', me fuqi të instaluar 810 kw", do të zëvendësohet me "hidrocentralet 'Germani 1' me fuqi të instaluar 4800 kw dhe 'Germani 2', me fuqi të instaluar 1500 kw".

- Fuqia totale e instaluar 4350 kw zëvendësohet me shprehjen, "fuqia totale e instaluar 6300 kw".

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 209, datë 27.9.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË AEE SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK "PLUG", ME FUQI TË INSTALUAR 2 mw, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË LUSHNJË, QARKU FIER

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "a"; të nenit 5, pika 1, germa "a" dhe të nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 15, të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 27.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë AEE sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Plug", me fuqi të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Bashkinë Lushnjë, qarku Fier,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 191, datë 30.8.2018, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë AEE sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Plug", me fuqi të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Bashkinë Lushnjë, qarku Fier.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE me shkresën nr. 55/56 prot., datë 30.8.2018, ka bërë njoftimin në median e shkruar, si dhe me shkresën nr. 549/1 prot., datë 3.9.2018, ka përcjellë pranë subjektit njoftimin e vendimit të fillimit të

procedurës, si dhe mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 4.4.5, germa "a" (miratimin e OST-së ose OSHEE-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose të shpërndarjes).

- Shoqëria AEE sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 549/2 prot., datë 10.9.2018, ka plotësuar dokumentacionin e sipërcituar, duke përcjellë miratimin e OSHEE-së nr. 13870/1 prot., datë 2.6.2017, për pikën e lidhjes së centralit fotovoltaik.

- Aplikimi i shoqërisë AEE sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika, germat "a", "b", "c", "d", "e", "f" dhe "g") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4 dhe 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Subjekti AEE sh.p.k. ka marrë miratimin përfundimtar nga MIE për një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër, ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar dhe të nenit 5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet. Por, duke qenë se nga studimi i fizibilitetit të paraqitur nga subjekti për centralin fotovoltaik "Plug", rezulton se jetëgjatësia e panelit shkon deri më 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë AEE sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Plug", me fuqi të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Bashkinë Lushnjë, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar (njëzetepesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 210, datë 27.9.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË AEE SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "e"; të nenit 5, pika 1, germa "e" dhe të nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 15, të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e datës 27.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë AEE sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 192, datë 30.8.2018, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë AEE sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE, me shkresën nr. 55/56 prot., datë 30.8.2018, ka bërë

njoftimin në median e shkruar, si dhe me shkresën nr. 549/1 prot., datë 3.9.2018, ka përcjellë pranë subjektit AEE sh.p.k. njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës.

- Aplikimi i shoqërisë AEE sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d" dhe "e") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat "a", "b", "c", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë AEE sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 211, datë 27.9.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "BE-IS ENERGY" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et: "KALIVARË 1", ME FUQI TË INSTALUAR 578 kw; "KALIVARË 2", ME FUQI TË INSTALUAR 1234 kw; "KALIVARË 3", ME FUQI TË INSTALUAR 1653 kw, DHE "KALIVARË 4", ME FUQI TË INSTALUAR 1998 kw, ME FUQI TOTALE 5463 kw, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË PUKË

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "a"; të nenit 5, pika 1, germa "a"; të nenit 10, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "BE-IS Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë nga HEC-et: "Kalivarë 1", me fuqi të instaluar 578 kw; "Kalivarë 2", me fuqi të instaluar 1234 kw; "Kalivarë 3", me fuqi të instaluar 1653 kw dhe "Kalivarë 4", me fuqi të instaluar 1998 kw, me fuqi totale 5463 kw, me vendndodhje në Bashkinë Pukë,

konstatoi se:

- Shoqëria "BE-IS Energy" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 580 prot., datë 6.9.2018, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: "Kalivarë 1", "Kalivarë 2", "Kalivarë 3" dhe "Kalivarë 4", me vendndodhje në Bashkinë Pukë.

- Aplikimi i shoqërisë "BE-IS Energy" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet

për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e", "g") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4 dhe 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor:
- Neni 9, pika 2, germa "f" (marrëveshje koncesioni ose autorizimi nga KM -ja, në rastet e aplikueshme, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës).
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal:

Neni 9, pika 3, germa "b" (bilanci financiar i tri viteve të fundit).

Neni 9, pika 3, germa "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit).

Për gjithë sa më sipër do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të paraqesë në ERE dokumentacionin e munguar, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "BE-IS Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: "Kalivar 1", me fuqi të instaluar 578 kw; hidrocentrali "Kalivar 2", me fuqi të instaluar 1234 kw; hidrocentrali "Kalivar 3", me fuqi të instaluar 1653 kw, dhe hidrocentrali "Kalivar 4", me fuqi të instaluar 1998 kw, me fuqi totale të instaluar 5463 kw, me vendndodhje në Bashkinë Pukë, për një afat 30-vjeçar (tridhjetëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 212, datë 27.9.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "DON-UCD" SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "d"; të nenit 5, pika 1, germa "d"; të nenit 10, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 27.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "DON-UCD" sh.p.k., në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "DON-UCD" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 592 prot., datë 17.9.2018, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë "DON-UCD" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:
- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c"): plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a, "b", "c" dhe "d"): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d"): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat "a", "b", "c", "d", "e" dhe "f"): plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa "e" (struktura e ndërtimit të shoqërisë).

Do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", ta paraqesë atë në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "DON-UCD" sh.p.k., në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 213, datë 27.9.2018

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN SHTATOR 2018

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 86, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. nr. 144, datë 25.6.2018, mbi rishikimin e "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit"; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 27.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga furnizuesi i mundësisë së fundit", për muajin shtator 2018,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me anë të shkresës nr. 17494 prot., datë 14.9.2018, paraqiti në ERE aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga furnizuesi i mundësisë së fundit, për muajin shtator 2018.

- Informacioni i dërguar në këtë shkresë është përgatitur në mbështetje të vendimit të Bordit të ERE-s. 144, datë 25.6.2018, mbi rishikimin e "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit", pikërisht nenit, të rishikuar; të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017.

- Duke u mbështetur në formulën përllogaritëse të nenit 8 të metodologjisë së sipërcituar, OSHEE sh.a., ka përcaktuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit, për muajin shtator 2018, si vijon:

Çmimi FMF i llogaritur nga OSHEE sh.a për muajin Shtator 2018			
a.	Çmimi maksimal i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	8.5652	Lekë/kWh
b.	Kthimi për riskun (në përqindje)	0.26	Lekë/kWh
c.	**Çmimi maksimal i blerjes për periudhën në fjalë**	**8.82**	**Lekë/kWh**
d.	Kosto administrative e FMF	1.79	Lekë/kWh
e.	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	0.75	Lekë/kWh
f.	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në 35 kV	1.5	Lekë/kWh
Çmimi i energjisë elektrike aktive (c + d + e + f)		**12.86**	**Lekë/kWh**

- Bashkëngjitur këtij aplikimi, OSHEE sh.a. ka paraqitur komunikimin shkresor (nr. 2210 prot., datë 4.9.2018) nga drejtori i Departamentit të Tregtimit të Energjisë Elektrike, në lidhje me sigurimin e sasisë së energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për klientët e lidhur në 35 kV, të cilët ndodhen në kushtet e furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit, për muajin shtator 2018.

- Në bazë të vendimit nr. 19, datë 19.1.2018 të Bordit të ERE-s, "Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për vitin 2018", çmimi për blerjen e energjisë nga prodhuesit me përparësi për vitin 2018 është 8.5652 lekë/kwh.

- Për sa deklarohet nga OSHEE sh.a., me shkresën nr. 8814/1, datë 24.5.2018, se: "OSHEE sh.a. nuk ka ndarje të llogarive midis aktivitetit të furnizimit dhe shpërndarjes dhe vijon të mos ketë ndarje të tyre edhe sot" dhe, se: "OSHEE nuk ka pasur një strukturë të posaçme për evidentimin e kostove të administrimit dhe atyre të disbalancave për klientët e FMF-së", është e arsyeshme që, për sa kohë që nuk ka ndarje të llogarive midis aktiviteteve, si dhe mungesa e një strukture për evidentimin e kostove për klientët FMF, me qëllim përcaktimin e kostove administrative (elementi CA i formulës), të pranohet si e arsyeshme kostoja për njësi prej 1,79 lekësh/kwh, e paraqitur nga OSHEE sh.a., si më sipër.

- Në vijim, me ndarjen administrative/ organizative të OSHEE sh.a., sipas aktiviteteve do të jetë i mundur saktësimi i këtyre kostove dhe axhustimi i tyre për periudhat e mëparshme, në përputhje me "Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit".

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, miratuar me vendimin nr. 210, datë 28.12.2017, "Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a., për vitin 2018" është 0.75 lekë/kwh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, miratuar me vendimin nr. 190, datë 30.8.2018, "Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OSHEE sh.a. për tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018" është 1.5 lekë/kwh.

- Në përfundim, nga verifikimi i informacionit dhe i përllogaritjeve të paraqitura nga shoqëria rezulton se çmimi për shitjen e energjisë elektrike për klientët në kushtet e FMF-së për muajin shtator 2018 është 12.86 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e furnizimit me energji elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga furnizuesi i mundësisë së fundit prej 12,86 lekësh/kwh për muajin shtator 2018.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 214, datë 11.10.2018

MBI MIRATIMIN E KODIT TË RRJETIT MBI RREGULLAT E NDËRVEPRIMIT DHE TË SHKËMBIMIT TË TË DHËNAVE

Në mbështetje të nenit 16, të nenit 44 dhe të nenit 55, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror" dhe të nenit 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe parashikimeve të vendimit nr. 2018/02/PHLG-EnC, datë 12.1.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 11.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi miratimin e Kodit të Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe të Shkëmbimit të të Dhënave,

konstatoi se:

- Operatori i kombinuar i gazit natyror, "Albgaz" sh.a. ka përshtatur draftrregulloren dhe Kodin e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe të Shkëmbimit të të Dhënave, duke e paraqitur për shqyrtim dhe miratim në ERE, me shkresën nr. 101 prot., datë 8.8.2018.

- Shqipëria është anëtare e Komunitetit të Energjisë që nga data 1.7.2006 dhe, si e tillë duhet të mbajë në konsideratë:

- parashikimet e Rregullores së BE-së nr. 715/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;

- kërkesat e Rregullores së Komisionit (KE) 2015/703, të datës 30 prill 2015;

- vendimin nr. 2018/02/PHLG.EnC, datë 12.1.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, me të cilin është miratuar Kodi i Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe të Shkëmbimit të të Dhënave.

- Gjithashtu, gjatë përshtatjes së Kodit të Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe të Shkëmbimit të të Dhënave, nga shoqëria "Albgaz" sh.a. janë mbajtur në konsideratë:

- parashikimet e ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror";

- licencimi i shoqërisë "Albgaz" sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror;

- licencimi i shoqërisë "Albgaz" sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror;

- certifikimi përfundimtar i operatorit të kombinuar të gazit natyror "Albgaz" sh.a.

- Shoqëria "Albgaz" sh.a. gëzon statusin e vëzhguesit pranë ENTSO-G, Rrjetit Evropian të Operatorëve të Transmetimit të Gazit Natyror.

- Sipas Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ky Kod duhet të transpozohet pa ndryshuar tekstin apo strukturën e tij.

- Me vendimin nr. 197, datë 3.9.2018, Bordi i ERE-s ka filluar procedurat për miratimin e Kodit të Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe të Shkëmbimit të të Dhënave, propozuar nga operatori i kombinuar i gazit natyror "Albgaz" sh.a.

- Me shkresën e ERE-s nr. 55/57 prot. është bërë njoftimi në median e shkruar në datat 5.9.2018 dhe 6.9.2018 dhe janë ftuar palët e interesuara për të paraqitur objeksionet në lidhje me sa më sipër. Në përfundim të afatit 15-ditor nuk ka objeksione nga palë të interesuara.

- Autoriteti i Konkurrencës, me vendimin nr. 550, datë 4.10.2018, "Për dhënien e rekomandimeve për Kodin e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe të Shkëmbimit të të Dhënave, propozuar nga operatori i kombinuar i gazit natyror "Albagaz" sh.a., i rekomandon ERE-s transpozimin e dokumentit të sipërcituar, pa ndryshime, si dhe kërkon informim në lidhje me zbatimin e rekomandimit brenda 90 ditëve. Ky rekomandim përputhet me vendimmarrjen e Bordit të ERE-s për fillimin e procedurave.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e Kodit të Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe të Shkëmbimit të të Dhënave.

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht) ka përparësi, në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

RREGULLORE
E BE-së NR. 2015/703, E DATËS 30 PRILL 2015,
MBI THEMELIMIN E KODIT TË RRJETIT MBI RREGULLAT E NDËRVEPRIMIT DHE TË SHKËMBIMIT TË TË DHËNAVE

E përshtatur sipas vendimit nr. 2018/02/PHLG.EnC, datë 12.1.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

1. Kjo Rregullore themelon një kod të rrjetit që specifikon rregullat mbi ndërveprimin dhe shkëmbimin e të dhënave, si dhe rregulla të harmonizuara për aktivitetin e sistemeve të transmetimit të gazit.

2. Kjo Rregullore zbatohet për pikat e interkoneksionit midis Palëve Kontraktuese në Komunitetin e Energjisë. Aplikimi në pikat e interkoneksionit brenda një Pale është subjekt i vendimit të autoritetit përkatës kombëtar rregullator. Lidhur me publikimin e të dhënave, neni 13 zbatohet për pikat përkatëse, siç parashikohet në paragrafin 3.2 të shtojcës I të Rregullores (KE) nr. 715/2009, përveç pikave të interkoneksionit; neni 17 zbatohet për pika të tjera në sistemin e transmetimit ku matet cilësia e gazit. Neni 18 zbatohet për sistemin e transmetimit. Kjo Rregullore zbatohet, gjithashtu, në pikat e hyrjes dhe të daljes në vende të treta, objekt vendimi i autoriteteve vendëse.

Neni 2
Përcaktime

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje do të zbatohen përcaktimet në nenin 2 të Rregullores (KE) nr. 175/2009; në nenin 3 të Bordit Rregullator të Sekretariatit (BE) nr. 984/2013; në nenin 3 të Bordit Rregullator të Sekretariatit nr. 312/2014, si dhe në nenin 2 të Direktivës 2009/73/KE.

a) "Ngjarje e jashtëzakonshme" do të thotë çdo ngjarje e paplanifikuar që është jashtë kontrollit normal apo e paparashikuar, që mund të ndodhë për një periudhë të caktuar, reduktimi kapaciteti që ndikon sasinë ose cilësinë e gazit në një pikë të caktuar interkoneksioni, me pasoja të mundshme në ndërveprimet midis operatorëve të sistemeve të transmetimit, si dhe midis operatorit të sistemit të transmetimit dhe përdoruesve të rrjetit.

b) "Operatori iniciues i sistemit të transmetimit" do të thotë operatori i sistemit të transmetimit që inicion procesin e përputhjes nëpërmjet dërgimit të të dhënave të nevojshme tek operatori i sistemit të transmetimit pritës.

c) "Rregulla e më të voglit" do të thotë në rast të sasive të ndryshme të procesuara në secilën anë të pikës së interkoneksionit, sasia që do të konfirmohet është e barabartë me sasinë më të vogël nga dy sasitë e procesuara.

d) "Proces përputhjeje" është procesi i krahasimit dhe radhitjes së sasive të gazit për përdoruesit e rrjetit në të dyja anët e një pike interkoneksioni specifike që rezulton në sasi të konfirmuara për përdoruesit e rrjetit.

e) "Operatori përputhës i sistemit të transmetimit" do të thotë operatori i sistemit të transmetimit që kryen procesin e përputhjes dhe dërgon rezultatet e procesit të përputhjes tek operatori iniciues i sistemit të transmetimit.

f) "Sasi e matur" do të thotë sasia e gazit që sipas pajisjeve matëse nga operatori i sistemit të transmetimit ka rrjedhur fizikisht përmes një pike interkoneksioni në një njësi kohore.

g) "Llogaria e balancimit operacional" do të thotë një llogari midis operatorëve fqinjë të sistemit të transmetimit për t'u përdorur për të menaxhuar diferencat thelbësore në një pikë interkoneksioni në mënyrë që të thjeshtëzojnë kontabilizimin e gazit për përdoruesit e rrjetit të përfshirë në një pikë interkoneksioni.

h) "Sasi e procesuar" do të thotë sasia e gazit e përcaktuar nga operatori iniciues i sistemit të transmetimit dhe nga operatori përputhës i sistemit të transmetimit që merr në konsideratë nominimet dhe rinominimet e përdoruesve të rrjetit, si dhe dispozitat kontraktore, siç parashikohen nga kontratat përkatëse të transportit dhe e cila përdoret si baza e procesit të përputhjes.

i) "Diferenca thelbësore" do të thotë diferenca midis sasisë së gazit që operatorët e sistemeve të transmetimit kanë skeduluar për rrjedhje dhe sasisë të matur në një pikë interkoneksioni.

j) "Dita e gazit" do të thotë periudha nga ora 05:00 deri në 05:00 UTC ditën, për periudhën e

dimrit dhe nga ora 04:00 deri në 04:00 UTC ditën tjetër kur zbatohet kursimi i ditës.

k) "Marrëveshja e interkoneksionit" nënkupton një marrëveshje të lidhur nga operatorët e sistemit të transmetimit ngjitur, sistemet e të cilëve janë të lidhur në një pikë të veçantë interkoneksioni, e cila specifikon termat dhe kushtet, procedurat operative dhe dispozitat, në lidhje me dërgimin dhe/ose tërheqjen e gazit në pika e interkoneksionit, me qëllim të lehtësimit të ndërveprimit efikas të rrjeteve të transmetimit të ndërlidhur.

l) "Pikë interkoneksioni" nënkupton një pikë fizike ose virtuale që lidh sistemet e hyrje-daljeve ngjitur ose lidh një sistem hyrje-daljeje me një ndërlidhës, për aq sa këto pika u nënshtrohen procedurave të rezervimit nga përdoruesit e rrjetit.

m) "Pikë virtuale e interkoneksionit" nënkupton dy ose më shumë pika interkoneksioni që lidhin dy sistemet hyrëse-dalëse të afërta, të integruara së bashku për qëllime të ofrimit të një shërbimi të vetëm kapaciteti.

n) "Sasi e konfirmuar" nënkupton sasinë e gazit të konfirmuar nga një operator i sistemit të bartjes për t'u planifikuar ose për t'u riplanifikuar të rrjedhë në ditën e gazit D.

o) "Alokim" nënkupton sasinë e gazit që i atribuohet një përdoruesi të rrjetit nga një operator i sistemit të bartjes si një input ose një matje e shprehur në kwh, me qëllim të përcaktimit të sasisë ditore të disbalancimit.

p) "Cikli i rinominimit" nënkupton procesin e kryer nga operatori i sistemit të bartjes për të siguruar një përdorues rrjeti me njoftimin në lidhje me sasitë e konfirmuara pas marrjes së një rinominimi.

KREU II
MARRËVESHJET E INTERKONEKSIONIT

Neni 3
Dispozita të përgjithshme

Operatorët fqinjë të sistemeve të transmetimit do të garantojnë që të paktën një nga termat dhe kushtet e mëposhtëm, të përkufizuara në nenin 6 dhe 12, janë përfshirë nga ndonjë marrëveshje interkoneksioni në të ardhmen apo ekzistuese për secilën nga pikat e interkoneksionit:

a) Rregullat për kontrollin e rrjedhës;

b) Parimet e matjes së sasisë dhe të cilësisë së gazit;

c) Rregullat për procesin e përputhjes;

d) Rregullat për alokimin e sasive të gazit;

e) Procedurat e komunikimit në rast të ngjarjeve të jashtëzakonshme;

f) Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të marrëveshjeve të interkoneksionit;

g) Procesin e amendimit të marrëveshjeve të interkoneksionit.

Neni 4
Detyrimet për informim

1. Operatorët e sistemeve të transmetimit do të identifikojnë informacionin në përmbajtje të marrëveshjeve të interkoneksionit që ndikojnë drejtpërdrejt përdoruesit e rrjetit dhe do t'i informojnë ata menjëherë.

2. Përpara nënshkrimit apo amendimit të një marrëveshjeje interkoneksioni që përmban rregullat sipas nenit 3 (c), (d) dhe (e), operatorët e sistemeve të transmetimit do të ftojnë përdoruesit e rrjetit të komentojnë mbi tekstin e propozuar të atyre rregullave, të paktën dy muaj përpara nënshkrimit apo amendimit të marrëveshjes. Operatorët e sistemeve të transmetimit do të marrin në konsideratë komentet e përdoruesve të rrjetit, kur të nënshkruajnë apo amendojnë marrëveshjet e tyre të interkoneksionit.

3 Afatet e detyrueshme të marrëveshjeve të interkoneksionit, listuar në nenin 3 apo çdo amendim i nënshkruar dhe që ka hyrë në fuqi para kësaj Rregulloreje, do të njoftohet nga operatorët e sistemeve të transmetimit tek autoritetet rregullatore vendëse dhe në ENTSOG brenda 10 ditësh pas nënshkrimit apo amendimit të marrëveshjes. Operatorët e sistemeve të transmetimit, gjithashtu, do të njoftojnë marrëveshjet e interkoneksionit tek autoritet rregullatore vendëse të Palës Kontraktore, brenda 10 ditësh nëse u kërkohet.

Neni 5
Shembull marrëveshjeje interkoneksioni

1. Nëse operatorët fqinjë të sistemeve të transmetimit nuk kanë dakordësi në një apo më shumë terma dhe kushte, sipas nenit 6 dhe 10 në marrëveshjen e tyre të interkoneksionit, sipas nenit 3, ata do të nënshkruajnë një marrëveshje interkoneksioni, bazuar në shembullin e ENTSOG-ut, për sa u përket atyre elementeve për të cilat nuk binin dakord.

Neni 6
Rregullat për kontrollin e rrjedhës

1. Në lidhje me kontrollin e rrjedhës, operatorët fqinjë të sistemeve të transmetimit do të:

a) Garantojnë se rregullat janë themeluar në mënyrë të tillë që të thjeshtëzohet një rrjedhë gazi e kontrollueshme, e saktë, e parashikueshme dhe efikase nëpërmjet një pike interkoneksioni;

b) Garantojnë se rregullat janë themeluar për të drejtuar rrjedhën e gazit nëpërmjet një pike interkoneksioni dhe për të minimizuar devijimet e rrjedhës sipas procesit të përputhjes;

c) Emërojnë operatorin e sistemit të transmetimit përgjegjës për drejtimin e rrjedhës së gazit nëpërmjet pikës së interkoneksionit. Nëse operatorët fqinjë të sistemeve të interkoneksionit nuk gjejnë dakordësi për këtë emërim, operatori i sistemit të transmetimit që administron pajisjet matëse do të jetë përgjegjës, në bashkëpunim me operatorin/ët fqinj/ë të sistemit të transmetimit, për drejtimin e rrjedhës së gazit nëpërmjet një pike interkoneksioni.

2. Për drejtimin e rrjedhës së gazit, operatorët fqinjë të sistemeve të transmetimit do të vendosin për sasinë dhe drejtimin e rrjedhës së gazit, për çdo pikë interkoneksioni dhe për çdo orë të ditës së gazit.

Operatori i emëruar i sistemit të transmetimit sipas pikës "c", të paragrafit 1, do të jetë përgjegjës për drejtimin e rrjedhës së gazit nëpërmjet pikës së interkoneksionit, duke garantuar se detyrimet kontraktore mbi presionin janë të përmbushura midis të gjithë operatorëve fqinjë të sistemeve të transmetimit:

a) Në një nivel saktësie të mjaftueshëm për të minimizuar diferencat thelbësore; dhe

b) Në një nivel qëndrueshmërie në përputhje me përdorimin efikas të rrjeteve të transmetimit të gazit.

3. Sasia dhe drejtimi i rrjedhës së gazit, të vendosur nga operatorët fqinjë të sistemeve të transmetimit, do të reflektojnë:

a) Rezultatin e procesit të përputhjes;

b) Korrigjimin e llogarisë së balancimit operacional;

c) Çdo dakordësim efikas për kontrollin e rrjedhës midis operatorëve fqinjë të sistemeve të transmetimit, për qëllime të tilla, si *ramp-up, ramp-down,* rrjedhë minimale, ndarje e rrjedhës në një pikë interkoneksioni virtuale, nëse ka dhe/ose ndryshimin e drejtimit të rrjedhës ose eficiencë kostoje operacionale;

d) Çdo dakordësim në menaxhimin e kufizimeve të tregtimit ndërkufitar, për shkak të diferencave të cilësisë së gazit, sipas nenit 15 dhe/ose praktikat e aromatizimit sipas nenit 19.

4. Një operator sistemi të transmetimit mund të vendosë të alternojë sasinë e gazit ose drejtimin e gazit, ose të dyja, nëse është e nevojshme, në mënyrë që:

a) Të zbatojë dispozitat e caktuara nga legjislacioni kombëtar ose i BE-së për sigurinë e aplikueshme në pikat e interkoneksionit;

b) Të zbatojë përcaktimet e planeve të emergjencës dhe planeve të veprimit preventive, sipas legjislacionin në fuqi të Komunitetit të Energjisë për sigurinë e furnizimit me gaz;

c) Të reagojë, në rast se operatori i sistemit ndikohet nga një ngjarje e jashtëzakonshme.

Neni 7
Parimet e matjes për sasinë dhe cilësinë e gazit

1. Lidhur me parimet e matjes për vëllimin, energjinë dhe cilësinë e gazit, operatorët fqinjë të sistemeve të transmetimit do të garantojnë që:

a) Detajet e standardeve të matjes, të aplikueshme janë të përcaktuara për pikën e interkoneksionit;

b) Identifikohet operatori përgjegjës i sistemit të transmetimit për instalimin, operimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve matëse. Ky operator do të ketë detyrimin të publikojë të gjithë informacionin dhe të dhënat në lidhje me rrjedhat e gazit në një pikë interkoneksioni tek operatori/ët fqinj/ë të sistemit të transmetimit në kohë dhe shpeshtësi.

2. Instalimi, operimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve matëse në një pikë interkoneksioni do të marrin në konsideratë kërkesat teknike të përcaktuara nga rregullatorët kombëtarë tek operatorët fqinjë të sistemeve të transmetimit.

3. Operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit do të bien dakord mbi parimet e matjes dhe duhet të përfshijnë të paktën:

a) Një përshkrim të stacionit të matjes, duke përfshirë pajisjet e matjes dhe të analizës që do të përdoren dhe detaje mbi secilën pajisje sekondare që mund të përdoret në rast avarie;

b) Parametrat e cilësisë, të vëllimit dhe të energjisë së gazit që do të matet, si dhe diapazonin dhe maksimumin e lejuar të gabimit apo të faktorit të pasigurisë brenda së cilëve do të punojë sistemi i matjes, frekuencën e matjeve, në cilat njësi matëse

dhe sipas cilave standardeve të matjes do të perfomohet dhe do të përdoren faktorët konvertues;

c) Procedurat dhe metodat që do të përdoren për përllogaritjen e atyre parametrave të cilët nuk kanë matje direkte;

d) Një përshkrim të metodës së përllogaritjes së maksimumit të marzhit të gabimit të lejuar apo të pasigurisë në përcaktimin e energjisë të transportuar;

e) Një përshkrim të procesit të njohjes së të dhënave të përdorura për parametrat e matur;

f) Dakordësimin për miratimin e matjes dhe të sigurisë së cilësisë, duke përfshirë procedura verifikimi dhe axhustimi për t'u miratuar nga operatorët fqinjë të transmetimit;

g) Mënyrën se si merren të dhënat, duke përfshirë dhe shpeshtësinë, përmbajtjen, sipas parametrave të matur;

h) Një listë specifike me sinjalizime dhe alarme që duhet t'u jepet operatorëve fqinjë të sistemeve të transmetimit nga operatori që operon pajisje matjeje;

i) Metodën për përcaktimin e gabimit të korrigjimit ndaj një matjeje dhe çdo procedurë dytësore që mund të nevojitet në situata të përkohshme (ose mbi lexim ose nën lexim të gamës së pasigurisë). Ky operator i sistemit të transmetimit do të marrë masat e nevojshme për të ndaluar këtë situatë;

j) Rregullat e zbatueshme midis operatorëve fqinjë të sistemit të transmetimit, në rast të prishjes së pajisjeve matëse;

k) Rregullat e zbatueshme midis operatorëve fqinjë të transmetimit, për:

i. aksesin te facilitetet matëse;

ii. verifikime të mëtejshme të faciliteteve matëse;

iii. modifikimin e faciliteteve matëse;

iv. prezencën gjatë kalibrimit dhe mirëmbajtjes të faciliteteve matëse.

4. Nëse operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit nuk përmbushin detyrimet e tyre, sipas paragrafit 1 dhe 3:

a) Operatori i sistemit të transmetimit që kontrollon pajisjet matëse do të ketë përgjegjësinë e instalimit, operimit dhe mirëmbajtës së këtyre pajisjeve dhe duhet të informojë operatorin tjetër të transmetimit me të dhënat e matjes së rrjedhës së gazit në pikën e interkoneksionit në kohë;

b) Do të zbatojë standardin evropian EN1776 *"Gas Supply Natural Gas Measuring Stations Functional Requirements"*, në versionin e aplikueshëm sipas kohës.

Neni 8

Rregullat për procesin e përputhjes

1. Në lidhje me procesin e përputhjes, operatorët fqinjë të sistemeve të transmetimit do të përcaktojnë:

a) Rregullat për detajimin e procesit të përputhjes, duke marrë në konsideratë dakordësimet e nominimeve ditore-orare, aty ku aplikohet;

b) Rregullat përkatëse të komunikimit dhe të përpunimit të të dhënave midis operatorëve fqinjë të sistemit të transmetimit, në mënyrë që të përllogaritet sasia e procesuar dhe sasia e konfirmuar e përdoruesve të rrjetit dhe e sasisë së gazit që duhet të skedulohet për rrjedhë në pikën/at e interkoneksionit.

2. Nominimet dhe rinominimet do të menaxhohen si më poshtë vijojnë:

a) Zbatimi i rregullave të përputhjes do të çojë në sasi të barabarta të konfirmuara për çdo palë të përdoruesve të rrjetit, në dy anët e një pike interkoneksioni, atëherë kur sasitë e përpunuara nuk përputhen;

b) Operatorët fqinjë të sistemeve të transmetimit mund të bien dakord të mirëmbajnë ose të implementojnë rregulla përputhjeje të ndryshme nga rregulla e më të voglit, duke marrë në konsideratë që kjo rregull publikohet dhe përdoruesit e rrjetit ftohen të komentojnë mbi rregullën e propozuar të përputhjes, brenda një afati kohor, jo më pak se dy muaj pas publikimit të tij;

c) Operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit do të specifikojnë rolet e tyre respektive gjatë procesit të përputhjes, duke treguar kur njëri apo tjetri është operatori iniciues apo operatori i procesit të përputhjes;

d) Operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit do të specifikojnë skedulin e kohëzgjatjes për procesin e përputhjes, brenda ciklit të nominimeve ose të rinominimeve, duke marrë parasysh që një proces i plotë përputhjeje nuk zgjat më shumë se dy orë nga momenti i ciklit të nominimit ose të rinominimit, dhe do të konsiderojë:

i. të dhënat që duhet të shkëmbehen midis operatorëve fqinjë të sistemit të transmetimit, në

mënyrë që të kenë mundësi të informojnë përdoruesit e rrjetit mbi sasitë e tyre të konfirmuara përpara përfundimit të ciklit të noniminit ose të rinominimit, duke përfshirë një minimum të dhënash, siç citohet në paragrafin 4 (b);

ii. procesi i shkëmbimit të të dhënave sipas pikës "i" më lart, do të lejojë operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit të përmbushin të gjithë hapat e përllogaritjeve dhe të komunikimit në kohë dhe në afat të përshtatshëm.

3. Kur të përpunohen nominimet për një pikë interkoneksioni, operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit do të garantojnë së rrjedha e gazit në dy anët e një pike interkoneksioni përllogaritet në përputhje më ndonjë reduktim të përkohshëm të kapacitetit, për shkak të ndonjë prej kushteve sipas nenit 6(4) nga njëra apo dy anët e pikës së interkoneksionit.

4. Çdo marrëveshje interkoneksioni do të specifikojë në dispozitat e saj mbi shkëmbimin e të dhënave për procesin e përputhjes:

a) Përdorimin e të dhënave të shkëmbyera midis operatorëve fqinjë të sistemit të transmetimit për procesin e përputhjes;

b) Informacionin e harmonizuar të përmbledhur me të dhënat e shkëmbyera për procesin e përputhjes që do të përmbajnë të paktën listën e mëposhtme:

i. identifikimin e pikës së interkoneksionit;

ii. identifikimin e përdoruesit të rrjetit ose nëse aplikohet, identifikimin e portofolit të tij;

iii. identifikimin e palës që livron ose merr gaz nga përdoruesi i rrjetit ose nëse aplikohet, identifikimin e portofolit të tij;

iv. fillimin dhe fundin e kohës së rrjedhës së gazit për të cilën kryhet procesi i përputhjes;

v. ditën e gazit;

vi. sasitë e procesuara dhe të konfirmuara;

vii. drejtimin e rrjedhës së gazit.

5. Vetëm nëse operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit bien dakord ndryshe në marrëveshjen e interkoneksionit, do të zbatohen pikat e mëposhtme:

a) Operatorët e sistemit të transmetimit do të zbatojnë rregullën e më të voglit. Zbatimi i rregullës së më të voglit, si rregull bazë, mund të kushtëzohet vetëm në rast të plotësimit të kushteve të pikës 2.2.3.1 të shtojcës I të Rregullores (KE) nr. 715/2009. dhe se zbatimi i tij do të pengonte ofrimin e kapacitetit të garantuar nga procedurat e menaxhimit të konxhestionit;

b) Operatorët e sistemit të transmetimit që zotërojnë pajisjet e kontrollit të rrjedhës do të jenë operatorët përputhës të sistemit të transmetimit;

c) Operatorët e sistemit të transmetimit do të kryejnë procesin e përputhjes sipas hapave konsekutivë të mëposhtëm:

i. operatori iniciues i sistemit të transmetimit do të përllogaritë dhe do të dërgojë sasitë e procesuara të gazit, brenda 45 minutave nga fillimi i ciklit të nominimit ose të rinominimit;

ii. operatorët përputhës të sistemit të transmetimit do të përllogaritin dhe do të dërgojnë sasitë e konfirmuara të gazit, brenda 90 minutave nga fillimi i ciklit të nominimit ose të rinominimit;

iii. operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit do të dërgojnë sasitë e konfirmuara të gazit te përdoruesit e rrjetit dhe do të skedulojnë livrimin e gazit nëpërmjet pikës së interkoneksionit, brenda dy orëve nga fillimi i ciklit të nominimit ose të rinominimit. Këta hapa vijues do të përcaktohen pa paragjykuar kohëzgjatjen minimale të ndërprerjeve të vendosura bashkërisht nga operatorët e sistemit të transmetimit dhe sipas paragrafin 2 (d) të këtij neni.

Kohëzgjatja minimale e ndërprerjes së ndalimit për një orë të dhënë të gazit do të jetë dyzet e pesë minuta pas fillimit të ciklit të rieminimit për atë orë të gazit. Kur dy operatorë të sistemit të transmetimit dëshirojnë të shkurtojnë kohën e zgjatjes së ndërprerjeve, çdo marrëveshje e lidhur ndërmjet operatorëve të sistemit të transmetimit i nënshtrohet miratimit të autoritetit rregullator kombëtar kompetent.

Neni 9

Rregullat për alokimin e sasive të gazit

1. Në lidhje me alokimin e sasive të gazit, operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit do të themelojnë rregulla, duke garantuar qëndrueshmëri midis sasive të alokuara në dy anët e pikës së interkoneksionit.

2. Vetëm nëse marrëveshja e interkoneksionit e parashikon ndryshe, operatorët e sistemit të transmetimit do të përdorin një llogari të balancimit operacional. Operatori i sistemit të transmetimit që zotëron pajisjet e matjes do të ripërllogaritë llogarinë e balancimit operacional me sasi të vlefshme dhe të komunikojë rezultatin tek operatori/ët fqinj/ë të sistemit të transmetimit.

3. Aty ku aplikohet një llogari e balancimit operacional:

a) Diferenca thelbësore do të alokohet te një llogari e balancimit operacional e operatorëve fqinjë të sistemit të transmetimit dhe alokimet që çdo operator fqinj i sistemit të transmetimit do të paraqesë për përdoruesit e tij të rrjetit do të jenë të barabarta me sasitë e konfirmuara;

b) Operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit do të mbajnë një balancë të llogarisë së balancimit operacional që duhet të jetë sa më shumë e përafërt me zero;

c) Kufijtë e llogarisë së balancimit operacional do të mbajnë në konsideratë karakteristika specifike të secilës pikë interkoneksioni dhe/ose të rrjetit të transmetimit të interkoneksionit, sidomos:

i. karakteristikat fizike të pikës së interkoneksionit;

ii. kapacitetin depozitues *(linepack)* të secilit rrjet transmetimi;

iii. kapacitetet e plota teknike të pikës së interkoneksionit;

iv. dinamikat e rrjedhës së gazit te sistemet e transmetimit të ndërlidhura.

Aty ku arrihen kufijtë e përcaktuar të llogarisë së balancimit operacional, operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit mund të bien dakord të zgjerojnë ata kufij, në mënyrë që të mundësojnë alokime për përdorues rrjeti që barazojnë sasitë e tyre të konfirmuara ose ndryshe alokim të sasive të përdoruesve të rrjetit, të ndarë proporcionalisht sipas sasisë së matur.

4. Operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit mund të bien dakord të mbajnë ose të implementojnë një rregull alokimi të ndryshëm nga llogaria e balancimit operacional, nëse kjo rregull publikohet dhe përdoruesit e rrjetit ftohen të komentojnë mbi rregullën e propozuar të alokimit, të paktën dy muaj pas publikimit të rregullës së alokimit.

Neni 10

Procedurat e komunikimit në rast ngjarjeje të jashtëzakonshme

1. Operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit do të garantojnë se kanë themeluar procedura lehtësuese të komunikimit, të shpejta dhe simultane, në rast të ngjarjeve të jashtëzakonshme. Vetëm nëse është dakordësuar ndryshe, komunikimi midis operatorëve të përfshirë të sistemit të transmetimit do të bëhet me komunikim verbal, në anglisht, për njoftimet, duke e ndjekur dhe me konfirmim elektronik me shkrim.

2. Operatori i sistemit të transmetimit që ndikohet nga një ngjarje e jashtëzakonshme do të informojë përdoruesit e rrjetit në lidhje me pikën "b" dhe "c" të këtij paragrafi, minimalisht nëse ka një impakt potencial në sasitë e tyre të konfirmuara dhe operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit, në lidhje me pikën "a" dhe "c" të këtij paragrafi, për ekzistencën e një ngjarjeje të jashtëzakonshme dhe të japë të gjithë informacionet, mbi:

a) Impaktin e mundshëm mbi sasitë dhe cilësitë e gazit që mund të transportohet nëpërmjet një pike interkoneksioni;

b) Impaktin e mundshëm mbi sasitë e konfirmuara të përdoruesve aktivë të rrjetit në pikat relevante të interkoneksionit;

c) Fundin e pritshëm dhe aktual të një ngjarjeje të jashtëzakonshme.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve nga marrëveshjet e interkoneksionit

1. Operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit do të përpiqen të zgjidhin miqësisht çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga apo në lidhje me marrëveshjen e interkoneksionit dhe të specifikojnë një mekanizëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për ato çështje të cilat nuk zgjidhen miqësisht.

Mekanizmi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve do të përcaktojë të paktën:

a) Ligjin e zbatueshëm; dhe

b) Gjykatën kompetente ose termat dhe kushtet e përzgjedhjes së ekspertëve brenda kuadrit të një forumi institucional apo në një bazë *ad hoc* që mund të përfshijë arbitrazhin.

Neni 12

Procesi i amendimit

1. Operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit do të themelojnë një proces amendimi transparent dhe të detajuar të marrëveshjes së tyre të interkoneksionit, që aktivizohet me një njoftim me shkrim të një prej operatorëve të sistemit të transmetimit.

2. Nëse operatori fqinj i sistemit të transmetimit nuk arrin të gjejë një dakordësi mbi procesin e amendimit, ata mund të përdorin mekanizmin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas nenit 11.

KREU III
NJËSITË

Neni 13
Grupi i njësive të përbashkëta

1. Çdo operator i sistemit të transmetimit do të përdorë grupin e njësive të përbashkëta të përcaktuar në këtë nen, për çdo shkëmbim dhe publikim të dhënash në lidhje me Rregulloren (KE) nr. 715/2009.

2. Për parametrat e presionit, temperaturës, vëllimit, vlerës bruto kalorifike, energjisë dhe indeksit *Wobbe,* operatorët e sistemit të transmetimit do të përdorin:

a) Presioni: bar

b) Temperatura: ^{0}C (gradë celcius)

c) Vëllimi: m^3

d) Vlera bruto kalorifike (GCV): kwh/m^3

e) Energji: kwh (bazuar në GCV)

f) Indeksi *Wobbe*: kwh/m^3 (bazuar në GCV)

Për presionin, operatorët e sistemit të transmetimit do të cilësojnë nëse i referohet presionit absolut (bar (a)) ose të presuar (bar (g)).

Kushtet referencë për vëllimin do të jenë 0 ^{0}C dhe 1,01325 bar(a). Për GCV-në, energjinë dhe indeksin *Wobbe,* temperatura referencë e djegies është 25 ^{0}C.

Sa herë operatorët e sistemit të transmetimit komunikojnë të dhëna mbi vëllimin, GCV-në, energjinë dhe indeksin *Wobbe,* ata do të specifikojnë se mbi cilën bazë reference përllogariten këto vlera.

3. Në rastet kur një Palë Kontraktore është e lidhur vetëm me një tjetër Palë Kontraktore ose shteti anëtar të Bashkimit Evropian të operatorit fqinj të sistemit të transmetimit dhe palët me të cilat komunikojnë mund të bien dakord të vazhdojnë të përdorin një referencë tjetër për shkëmbimin e të dhënave në lidhje me Rregulloren (KE) nr. 715/2009, objekt miratimi nga autoritetet rregullatore kombëtare.

Neni 14
Njësi shtesë

Operatorët e sistemit të transmetimit dhe palët me të cilat komunikojnë në lidhje me Rregulloren (KE) nr. 715/2009 mund të bien dakord që të përdorin, përveç grupit të njësive të përbashkëta, njësi shtesë ose referenca për shkëmbimin dhe publikimin e të dhënave. Në këtë situatë, konvertimi midis referencave të ndryshme do të bëhet sipas përbërjes reale të gazit. Nëse të dhënat e përbërjes së këtij gazi nuk janë publike, faktorët e konvertimit që do të përdoren do të jenë në përputhje me shtojcën bazuar në EN ISO 13443, *"Natural gas - Standard reference conditions",* sipas versionit të zbatueshëm.

KREU IV
CILËSIA DHE AROMATIZIMI I GAZIT

Neni 15
Menaxhimi i kufizimeve tregtare ndërkufitare për shkak të diferencave në cilësinë e gazit

1. Operatorët e sistemit të transmetimit do të bashkëpunojnë në mënyrë që të shmangin kufizimet e tregtisë ndërkufitare, për shkak të diferencave në cilësinë e gazit. Këto veprime të filluara dhe të zhvilluara nga operatorët e sistemit të transmetimit, gjatë operimit të tyre standard, mund të përfshijnë, përveç të tjerave, shkëmbimin dhe bashkëkombinimin.

2. Aty ku kufizimet e tregtisë ndërkufitare, për shkak të diferencave në cilësinë e gazit, nuk mund të shmangen nga operatorët e sistemit të transmetimit dhe që njihen nga autoritetet rregullatore kombëtare, këto autoritete mund t'u kërkojnë operatorëve të sistemit të transmetimit të ndërmarrin brenda 12 muajsh, veprimet e cituara nga pika "a" në pikën "e" në sekuencë:

a) Të bashkëpunojnë dhe të zhvillojnë opsione teknike të mundshme, pa ndryshuar specifikat e cilësisë së gazit, që mund të përfshijnë angazhimin e rrjedhës dhe trajtimin e gazit në mënyrë që të heqin kufizimet e dalluara;

b) Të hartojnë bashkërisht një analizë të kostove dhe të përfitimeve mbi opsionin teknikisht të mundshëm, për të përcaktuar zgjidhje efikase ekonomike që do të shtjellojnë ndarjen e kostove dhe përfitimeve midis kategorive të palëve të ndikuara;

c) Të prodhojnë një vlerësim të afatit të zbatimit për secilin opsion potencial;

d) Të zhvillojnë një konsultim publik mbi zgjidhjet e mundshme të identifikuara dhe të marrin në konsideratë konkluzionet e konsultimit;

e) Të dorëzojnë një propozim të përbashkët për heqjen e kufizimeve të dalluara, duke përfshirë dhe kohëzgjatjen e zbatimit, bazuar në analizën e kostove dhe të përfitimeve dhe përfundimeve të konsultimit publik pranë autoriteteve rregullatore kombëtare për miratim dhe tek autoritetet

kombëtare kompetente për informacion për secilën palë kontraktore të përfshirë.

Atëherë kur operatorët e transmetimit të përfshirë nuk arrijnë në një përfundim, secili operator i sistemit të transmetimit do të informojë menjëherë autoritetin e tij rregullator.

3. Para miratimit të vendimit, sipas pikës "e", të paragrafit 2, secili autoritet rregullator kombëtar do të konsultohet me autoritetet rregullatore kombëtare të Palëve Kontraktore të përfshira. Gjatë miratimit të vendimit, secili rregullator kombëtar do të marrë në konsideratë opinionin e autoritetit rregullator fqinj me qasjen për të pasur një vendim të koordinuar bazuar në vendimmarrje të përbashkët.

Neni 16

Monitorimi afatshkurtër i cilësisë së gazit: publikimi i të dhënave

Operatorët e sistemit të transmetimit do të publikojnë në faqen e tyre për secilën pikë interkoneksioni, me një frekuencë të paktën një herë në orë gjatë ditës së gazit, indeksin *Wobbe* dhe vlerën bruto kalorifike për gazin që hyn direkt në rrjetin e tyre të transmetimit, në çdo pikë fizike interkoneksioni.

Përjashtim për pikat e interkoneksionit pa pajisjet adekuate të matjes, në momentin e miratimit të kësaj Rregulloreje, një frekuencë e botimit të indeksit *Wobbe* dhe vlerës së energjisë kalorifike, do të jetë një herë për ditë gazi. Në raste të tilla, operatori i sistemit të bartjes është i detyruar të paraqesë një kërkesë për përjashtim, pa vonesë tek autoriteti përkatës rregullator. Një kërkesë për përjashtim duhet të përfshijë një propozim për instalimin e pajisjeve adekuate të matjes, me afatin e saktë të vënies në përdorim të pajisjeve të tilla, të cilat nuk mund të jenë më të gjata se dy vjet. Një përjashtim duhet të konfirmohet nga autoritetet rregullatore që kanë juridiksion mbi operatorët e sistemit të transmetimit fqinjë.

ENTSOG-u do të publikojë në platformën e tij qendrore të të gjithë bashkimit të themeluar sipas pikës 3.1.1(1)(h) të shtojcës I të Rregullores (KE) nr. 715/2009, një link të faqes me informacionin përkatës në faqet e operatorëve të sistemit të transmetimit.

Neni 17

Dhënia e informacionit mbi variacionin e cilësisë së gazit afatshkurtër

1. Përveç pikave të interkoneksionit, ky nen do të zbatohet edhe për pikat e tjera të rrjetit të transmetimit ku matet cilësia e gazit.

2. Një operator i sistemit të transmetimit mund të përzgjedhë një ose disa nga palët e mëposhtme për të mbledhur informacion mbi variacionin e cilësisë së gazit:

a) Konsumatorët fundorë direkt të lidhur me rrjetin e operatorit të sistemit të transmetimit, të cilët ndikohen në proceset e tyre operacionale negativisht nga ndryshimet e cilësisë së gazit, ku nuk parashikohet nga legjislacioni në fuqi një kontratë direkte midis operatorit të sistemit të transmetimit dhe konsumatorit fundor drejtpërdrejt të lidhur në të;

b) Operatorët e sistemit të shpërndarjes direkt të lidhur me rrjetin e operatorit të sistemit të transmetimit, që janë të lidhur me konsumatorë fundorë të cilët ndikohen në proceset e tyre operacionale negativisht nga ndryshimet e cilësisë së gazit;

c) Operatorët e sistemit të depozitimit direkt të lidhur me rrjetin e operatorit të sistemit të transmetimit, të cilët ndikohen në proceset e tyre operacionale negativisht nga ndryshimet e cilësisë së gazit.

3. Çdo operator i sistemit të transmetimit do të:

a) Përkufizojë dhe do të përditësojë listën e palëve të titulluar të marrin informacion indikativ për cilësinë e gazit;

b) Bashkëpunojë me palët e identifikuara në listën e mësipërme në mënyrë që të vlerësojë:

i. informacionin që duhet të jepet rreth parametrave të cilësisë së gazit;

ii. frekuencën e informacionit që duhet të jepet;

iii. afatet e njoftimit;

iv. metodën e komunikimit.

4. Paragrafi 3 nuk do të detyrojë operatorët e sistemit të transmetimit të instalojnë masa të shtuara ose pajisje parashikuese, vetëm në rast se kërkohet nga autoriteti rregullator kombëtar. Informacioni sipas paragrafit 3 (b) (i) në këtë nen do të jepet siç e vlerëson operatori i sistemit të transmetimit në një kohë dhe për përdorim të brendshëm të përfituesit të këtij informacioni.

Neni 18
Monitorimi afatgjatë i cilësisë së gazit në sistemet e transmetimit

1. ENTSOG-u do të publikojë çdo dy vjet një perspektivë afatgjatë të monitorimit të cilësisë së gazit për sistemet e transmetimit, në mënyrë që të identifikohen trendet potenciale të parametrave të cilësisë së gazit dhe luhatjen potenciale respektive brenda 10-vjeçarit të ardhshëm. Perspektiva e parë afatgjatë e monitorimit të cilësisë së gazit do të publikohet së bashku me "Planin e zhvillimit dhjetëvjeçar të rrjetit", të vitit 2017.

2. Perspektiva do të bazohet në inputet e mbledhura në kuadër të bashkëpunimit rajonal të themeluar në ENTSOG, sipas nenit 12 (1) të Rregullores (KE) 715/2009.

3. Perspektiva afatgjatë e monitorimit të cilësisë së gazit do të përfshijë të paktën indeksin *Wobbe* dhe vlerën kalorifike. Parametra shtesë të cilësisë së gazit mund të përfshihen pas konsultimit me palët e interesit, sipas paragrafit 8.

4. Perspektiva afatgjatë e monitorimit të cilësisë së gazit do të identifikojë burime të reja furnizimi potenciale nga një pikëpamje e cilësisë së gazit.

5. Që të përcaktohet vlera referencë e parametrave të cilësisë së gazit për burimin respektiv të furnizimit që do të përdoret në perspektivë, duhet të bëhet një analizë e viteve të shkuara. Këto të dhëna mund të zëvendësohen nga inputet e palëve të interesit që rezultojnë nga procesi i angazhimit të palëve të interesit sipas paragrafit 8.

6. Për secilin parametër të cilësisë së gazit të shqyrtuar dhe të secilit rajon, analiza do të japë përfundime brenda një diapazoni ku parametri mund të zhvillohet.

7. Perspektiva afatgjatë e monitorimit të cilësisë së gazit do të jetë konsistente dhe e përputhur me "Planin e zhvillimit dhjetëvjeçar të rrjetit" përgjatë bashkimit që po hartohet.

8. Procesi i konsultimit të palëve të interesit i përdorur për "Planin e zhvillimit dhjetëvjeçar të rrjetit" përgjatë Bashkimit Evropian do të shtjellohet më shumë që të përfshihet edhe cilësia e gazit si një zë. Përgjatë këtij procesi, palët do të ftohen të dorëzojnë pikëpamjet e tyre në ENTSOG, mbi zhvillimin e parametrave të cilësisë së gazit për furnizim.

Neni 19
Menaxhimi i kufizimeve të tregtisë ndërkufitare, për shkak të diferencave në praktikat e aromatizimit

1. Atëherë kur një kufizim i tregtisë ndërkufitare, për shkak të diferencave në praktikat e aromatizimit, nuk mund të shmanget nga operatori i sistemit të transmetimit përkatës dhe njihet nga autoritetet kombëtare, këto autoritete mund t'u kërkojnë operatorëve të sistemit të transmetimit të arrijnë në një marrëveshje brenda gjashtë muajsh për të zgjidhur ndonjë kufizim të njohur, që mund të përfshijë shkëmbimin dhe angazhimet e rrjedhës. Operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit të përfshirë do të dorëzojnë marrëveshjen për miratim pranë autoritete kombëtare.

2. Atëherë kur nuk mund të arrihet një marrëveshje midis operatorëve fqinjë të transmetimit të përfshirë pas një periudhe gjashtëmujore, sipas paragrafit 1 ose, atëherë kur autoritetet kombëtare pranojnë se marrëveshja e propozuar nga operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit të përfshirë nuk është efektive mjaftueshëm për të hequr kufizimin, operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit të përfshirë, në bashkëpunim me autoritetet kombëtare, brenda 12 muajve, do të hartojnë një plan veprimi që specifikon metodën me kosto më efektive për të hequr një kufizim të identifikuar në një pikë specifike të interkoneksionit ndërkufitar.

3. Në mënyrë që të përmbushen detyrimet sipas paragrafit 2, operatorët e transmetimit të përfshirë do të kryejnë në sekuencë:

a) Hartimin e opsioneve për të hequr kufizimin, duke identifikuar dhe vlerësuar:

i. një konvertim të rrjedhës fizike ndërkufitare të gazit të paaromatizuar;

ii. rrjedhën fizike potenciale të gazit të aromatizuar në rrjetin e transmetimit të paaromatizuar ose pjesë të tij dhe, në sistemet e ndërlidhura *downstream*;

iii. një nivel të pranueshëm aromatizuesi për rrjedhën fizike ndërkufitare të gazit.

b) Bashkërisht hartimin e një analize kosto-përfitimi të opsioneve të mundshme teknike për përcaktimin e zgjidhjeve efikase ekonomike. Kjo analizë do të:

i. marrë në konsideratë nivelin e sigurisë;

ii. përfshijë informacion mbi vëllimet e projektuara të gazit që do të transportohet dhe detaje të kostove të domosdoshme për investime në infrastrukturë;

iii. specifikojë ndarjen e zërave të kostove dhe të përfitimeve midis kategorive të palëve të prekura;

c) Hartimin e një vlerësimi të afateve të implementimit për secilin opsion potencial;

d) Zhvillimin e një konsultimi publik dhe marrjen në konsideratë të përfundimeve të këtij konsultimi;

e) Dorëzimin e zgjidhjeve të mundshme pranë autoriteteve kombëtare për miratim, duke përfshirë mekanizmin e rikuperimit të kostove dhe afatet e implementimit.

Pasi zgjidhja miratohet nga autoritetet kombëtare, zgjidhja do të zbatohet sipas afatit kohor në pikën "e".

4. Nëse autoritetet kombëtare nuk miratojnë asnjë zgjidhje të dorëzuar për miratim, sipas pikës "e", të paragrafit 3, brenda gjashtë muajsh nga data e dorëzimit ose, nëse operatorët e sistemit të transmetimit të përfshirë nuk arrijnë të propozojnë një zgjidhje brenda afatit 12-mujor, sipas paragrafit 2, do të zbatohet një ndryshim në rrjedhën fizike ndërkufitare të gazit të paaromatizuar brenda kuadrit kohor të miratuar nga autoritetet kombëtare, por, sidoqoftë jo më gjatë se katër vjet. Pas ndryshimit të plotë në gaz të paaromatizuar, operatorët e sistemit të transmetimit do të pranojnë nivele teknike të paevitueshme të sasive të mbetura të aromatizuesve në rrjedhat ndërkufitare.

KREU V
SHKËMBIMI I TË DHËNAVE

Neni 20
Dispozita të përgjithshme

1. Për qëllimet e këtij kreu, palët do të jenë përdoruesit aktivë të rrjetit, në:

a) Pikat e interkoneksionit; ose

b) Edhe pikat e interkoneksionit edhe pikat virtuale të tregtimit.

2. Kërkesat për shkëmbimin e të dhënave midis operatorëve të sistemit të transmetimit dhe nga operatorët e sistemit të transmetimit te palët e tyre do të përmbushen nga zgjidhje të shkëmbimit të të dhënave të përbashkëta, sipas nenit 21 dhe, siç parashikohet nga pika 2.2, e shtojcës I, të Rregullores (KE) nr. 715/2009, Bordit Rregullator të Sekretariatit (BE) nr. 984/2013, Bordit Rregullator të Sekretariatit (BE) nr. 312/2014, Bordit Rregullator të Sekretariatit (BE) nr. 1227/2011 dhe kjo Rregullore.

Neni 21
Zgjidhjet për shkëmbimin e të dhënave të përbashkëta

1. Në varësi të kërkesave të shkëmbimit të të dhënave, sipas nenit 20 (2), mund të zbatohet dhe përdoret një apo më shumë nga mënyrat e mëposhtme të shkëmbimeve të të dhënave:

a) Shkëmbim të dhënash sipas dokumentacionit: të dhënat përmblidhen në një dosje dhe shkëmbehen automatikisht midis sistemeve IT respektive;

b) Shkëmbim i integruar i të dhënave: të dhënat shkëmbehen midis dy aplikimeve drejtpërdrejt në sistemet IT respektive;

c) Shkëmbim interaktiv i të dhënave: të dhënat shkëmbehen në mënyrë interaktive nëpërmjet një aplikacioni në internet nëpërmjet një shfletuesi.

2. Zgjidhjet e shkëmbimit të të dhënave të përbashkëta do të jenë të përbëra nga protokollet, formati i të dhënave dhe rrjeti. Zgjidhjet e mëposhtme të të dhënave të përbashkëta do të përdoren për çdo mënyrë të shkëmbimit të të dhënave, siç listohen në paragrafin 1:

a) Për shkëmbimin sipas dokumentacionit:

i. protokolli: AS4;

ii. formati i të dhënave: Edig@s-XML ose një format të dhënash ekuivalent që garanton shkallën identike të ndërveprimit, sipas publikimit të ENTSOG-ut.

b) Për shkëmbimin e integruar të të dhënave:

i. protokolli: HTTP/S-SOAP;

ii. formati i të dhënave: Edig@s-XML ose një format të dhënash ekuivalent që garanton shkallën identike të ndërveprimit, sipas publikimit të ENTSOG-ut.

c) Për shkëmbimin interaktiv të të dhënave protokolli do të jetë HTTP/S.

Për të gjitha mënyrat e shkëmbimit të të dhënave, sipas pikës "a" dhe "c", rrjeti do të jetë interneti.

Neni 22
Disponueshmëria dhe siguria e sistemit të shkëmbimit të të dhënave

1. Çdo operator i sistemit të transmetimit dhe çdo palë do të jenë përgjegjës për garantimin e masave të duhura të sigurisë. Veçanërisht, ata do të:

a) Garantojnë zinxhirin e komunikimit të siguritë dhe të besueshëm, duke përfshirë enkriptimin e konfidencialitetit si masë mbrojtëse, integritetin dhe vërtetësinë me firmën e dërguesit dhe mosrefuzimin me një konfirmim me shkrim;

b) Zbatojnë masa të përshtatshme të sigurisë, në mënyrë që të parandalohet aksesi i paautorizuar në infrastrukturën e tyre IT;

c) Njoftojnë palët e tjera me të cilat komunikojnë pa vonesë, në lidhje me ndonjë akses të paautorizuar që ka ose mund të ketë ndodhur në sistemin e tyre.

2. Secili operator i sistemit të transmetimit është përgjegjës për garantimin e disponueshmërisë së sistemit të tij dhe do të:

a) Marrë masat e nevojshme të parandalojë se sistemi i shkëmbimit të të dhënave mund të jetë i paaksesueshëm edhe në rast se ka një pikë të vetme dëmtimi, përshirë dhe lidhjen e rrjetit me ofruesit e shërbimit të internetit;

b) Përftojë shërbimin dhe mbështetjen e domosdoshme nga ofruesit e shërbimit të internetit;

c) Të minimizojë afatet e mirëmbajtjes së planifikuar të IT-së dhe të informojë në kohë palët e tij para padisponueshmërisë së planifikuar.

Neni 23

Zbatimi i zgjidhjeve të shkëmbimit të të dhënave të përbashkëta

1. Në varësi të kërkesave të shkëmbimit të të dhënave, sipas nenit 20 (2), operatorët e sistemit të transmetimit do të bëjnë të mundur përdorimin e zgjidhjeve të shkëmbimit të të dhënave sipas nenit 21.

2. Nëse ka zgjidhje të shkëmbimit të të dhënave midis një operatori të sistemit të transmetimit dhe palëve të tij, të cilat në datën 1 tetor 2018, duke marrë në konsideratë që zgjidhjet ekzistuese janë në përputhje me nenin 22 dhe kërkesave të shkëmbimit të të dhënave sipas nenit 20 (2), këto zgjidhje mund të aplikohen pas konsultimit me përdoruesit e rrjetit dhe objekt miratimi nga autoriteti rregullator kombëtar i operatorit të sistemit të transmetimit.

Neni 24

Procesi zhvillimor për mjetet e përbashkëta të operimit të rrjetit

1. Për çdo kërkesë të shkëmbimit të të dhënave sipas nenit 20 (2), ENTSOG do të zhvillojë një mjet të përbashkët të operimit të rrjetit, sipas nenit 8 (3) (a) të Rregullores (KE) nr. 715/2009 dhe do ta publikojë në faqen e tij. Një mjet i përbashkët i operimit të rrjetit do të specifikojë zgjidhjen përkatëse të shkëmbimit të të dhënave të përbashkëta për kërkesat respektive për shkëmbimin e të dhënave, siç përcaktohet në nenin 21. Një mjet i përbashkët i operimit të rrjetit mund të përfshijë, gjithashtu, edhe specifikimet e kërkesave të biznesit, menaxhimin e çlirimit dhe udhëzimet e implementimit.

KREU VI

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 25

Monitorimi i implementimit

1. Gjashtë muaj pas përfundimit të afatit për transpozimin dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë do të monitorojë dhe do të analizojë se si operatorët e sistemit të transmetimit kanë zbatuar kapitujt II deri V të kësaj Rregulloreje dhe do t'i dorëzojnë një raport në lidhje me këtë Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë

2. Jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të afatit për transpozimin dhe zbatimit të kësaj Rregulloreje, operatorët e sistemit të transmetimit do t'i komunikojnë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë të gjitha informacionet e nevojshme që i mundësojnë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë që të përmbushë detyrimet e tij sipas paragrafit 1.

Neni 26

Hyrja në fuqi

1. Çdo Palë Kontraktuese do të transpozojë dhe do të zbatojë Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 2015/703 deri më 1 tetor 2018.

2. Vendimi [2018/02/PHLG-EnC] do të bëhet i detyrueshëm për të gjithë pjesëmarrësit e tregut. Transpozimi do të bëhet pa ndryshime në strukturën dhe në tekstin e Rregullores së Komisionit (BE) 2015/703, përveç përkthimit dhe përshtatjeve të bëra me këtë vendim.

3. Çdo Palë Kontraktuese do të njoftojë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për transpozimin e plotësuar brenda dy javësh pas miratimit të këtyre masave.

4. Në transpozimin e vendimit [2018/02/PHLG-EnC] Palët Kontraktuese do të detyrojnë autoritetet rregullatore kombëtare me monitorimin dhe me zbatimin në përputhshmëri me këtë vendim [2018/02/PHLG-EnC].

SHTOJCË
FAKTORËT E KONVERTIMIT MIDIS KUSHTEVE REFERENCË

Temperature referencë në °C (djegie, vëllim)	25/20 deri 25/0	25/20 deri **15/15**	25/20 deri 0/0	25/20 deri **15/15**	25/0 deri 0/0	**15/15** deri 0/0
Vlerë superiore kalorifike reale e bazuar në vëllim	1,0738	1,0185	1,0766	0,9486	1,0026	1,0570
Vlerë inferiore kalorifike reale e bazuar në vëllim	1,0738	1,0176	1,0741	0,9477	1,0003	1,0555
Indeksi real Wobbe	1,0736	1,0185	1,0764	0,9487	1,0026	1,0569

REGULATION (EU) NO 703/2015 OF 30 APRIL 2015 ESTABLISHING A NETWORK CODE ON INTEROPERABILITY AND DATA EXCHANGE RULES

Incorporated and adapted by Permanent High Level Group Decision 2018/02/PHLG-EnC of 12 January 2018

CHAPTER I GENERAL PROVISIONS

Article 1
Subject matter and scope

1. This Regulation establishes a network code which sets out rules regarding interoperability and data exchange as well as harmonised rules for the operation of gas transmission systems.

2. This Regulation shall apply at interconnection points **between the Contracting Parties to the Energy Community. The application at interconnection points within a Party is subject to the decision of the relevant national regulatory authority.** With regard to data publication, Article 13 shall apply to relevant points defined in paragraph 3.2 of Annex I to Regulation (EC) No 715/2009. In addition to interconnection points, Article 17 shall apply to other points on transmission network where the gas quality is measured. Article 18 shall apply to transmission systems. This Regulation may also apply at entry points from and exit points to third countries, subject to the decision of the national authorities.

Article 2
Definitions

For the purposes of this Regulation, the definitions in Article 2 of Regulation (EC) No 715/2009 ... as well as in Article 2 of Directive 2009/73/EC shall apply. In addition, the following definitions shall apply:

a) 'Exceptional event' means any unplanned event that is not reasonably controllable or preventable and that may cause, for a limited period, capacity reductions, affecting thereby the quantity or quality of gas at a given interconnection point, with possible consequences on interactions between transmission system operators as well as between transmission system operator and network users;

Në mbështetje të nenit 16; të nenit 19, germa "d"; të nenit 37, pika 2, germa "ç" dhe të nenit 44, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 2 dhe të nenit 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, të ndryshuar, "Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike"; të nenit 4, pika 1, germa "c"; të nenit 5, pika 1, germa "c"; të nenit 13; të nenit 17, pikat 1, 2, 4 dhe 5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe të nenit 15, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, mbi transferimin e licencës së furnizimit energjisë elektrike me nr. 251, seria P14FPP, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014 dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë "Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike" sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016, te shoqëria "Furnizuesi i shërbimit universal" sh.a. (FSHU sh.a.),

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 7818 prot., datë 27.4.2018, ka përcjellë në ERE dokumentacionin për transferimin e licencave/ licencimin e shoqërive të kontrolluara nga OSHEE sh.a.

- Me shkresën nr. 2 prot., datë 27.4.2018, "Furnizuesi i shërbimit universal" sh.a. (FSHU sh.a.) ka paraqitur në ERE kërkesën për transferimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëria "Furnizuesi i shërbimit universal" sh.a. (FSHU sh.a.).

- Shoqëria "Furnizuesi i shërbimit universal" sh.a. (FSHU sh.a.) është themeluar me statusin e shoqërisë aksionare në zbatim të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar;

të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe të urdhrit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 157 prot., datë 12.2.2018, të shoqërisë OSHEE sh.a., në cilësinë e aksionarit themelues. Data e themelimit është 28.3.2018.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 122, datë 4.6.2018, vendosi të fillojë procedurën për transferimin e licencës së furnizimit të shërbimit universal të energjisë elektrike, të shoqërisë "Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike" sh.a. (OSHEE sh.a), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, e vlefshme deri në datën 27.10.2019, te shoqëria "Furnizuesi i shërbimit universal" sh.a. (FSHU sh.a.).

- Pas vendimmarrjes së sipërcituar, ERE, në zbatim të nenit 10, pikat 8 dhe 9, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", me shkresën nr. 55/36 prot., datë 13.6.2018, bëri njoftimin në median e shkruar lidhur me kërkesën e bërë nga ky subjekt.

- Në përfundim të afatit të parashikuar në nenin 10, pika 11, të rregullores së sipërcituar, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me këtë aplikim.

- Shoqëria OSHEE sh.a. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me pakicë, me vendimin nr. 97, datë 27.10.2014, të Bordit të ERE-s, dhe mban licencën me nr. 251, seria P14FPP.

- Me shkresën nr. 7818 prot., datë 27.4.2018, protokolluar në ERE me nr. 355 prot., datë 30.4.2018, "Përcillet dokumentacioni ...", "Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike" (OSHEE sh.a.), ndër të tjera bën me dije, se: "Transferimi i personelit për këtë shoqëri, "Furnizuesi i shërbimit universal" (FSHU sh.a.) është në proces. Për rrjedhojë, lista e personelit, sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, do të plotësohet në vijim".

- Me shkresën nr. 355/5 prot., datë 9.8.2018, ERE i ka kërkuar aplikuesit plotësim dokumentacioni dhe me shkresën e datës 3.9.2018, protokolluar me tonën nr. 355/6 prot., "Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike" (OSHEE sh.a.) ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar për llogari të shoqërisë "Furnizuesi i shërbimit universal" (FSHU sh.a.).

- Aplikimi i shoqërisë FSHU sh.a. plotëson kryesisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 17, pika 2, germa "a", formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, germat "a", "b", "c"): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 17, pika 2, germa "b", dokumentet juridike, administrative dhe pronësore, sipas nenit 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e") është plotësuar kryesisht, me përjashtim të listës së personelit, sipas profilit në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 17, pika 2, germa "c", dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d"): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 4, germa "a" (Formati i aplikimit, sipas nenit 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 4, germa "b" (Një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Nenin 17, pika 4, germa "c" (Vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës): plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Transferimin e licencës së Furnizimit të Energjisë Elektrike me nr. 251, seria P14FPP, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, e vlefshme deri në datën 27.10.2019, dhe të detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë "Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike" sh.a. (OSHEE sh.a), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016, te shoqëria "Furnizuesi i shërbimit universal" sh.a. (FSHU sh.a.).

2. Shoqëria "Furnizuesi i shërbimit universal" sh.a. (FSHU sh.a.) të paraqesë në ERE listën e

personelit, sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, pasi të përfundojë transferimi i personelit për këtë shoqëri, "Furnizuesi i shërbimit universal" sh.a. (FSHU sh.a.), nga struktura përkatëse.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 216, datë 11.10.2018

MBI TRANSFERIMIN E LICENCËS PËR OPERIMIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË "OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE" SHA (OSHEE SHA), ME NR. 250, SERIA P14SH, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 96, DATË 27.10.2014, TE SHOQËRIA "OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES" SHA (OSSH SHA), E VLEFSHME DERI NË DATËN 27.10.2044

Në mbështetje të nenit 16, të nenit 37, pika 2, germa "c", si dhe të nenit 44 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "c"; të nenit 5, pika 1, germa "c"; të nenit 13 dhe të nenit 17, pikat 1, 2, 4 dhe 5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe të nenit 15 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi transferimin e licencës së operimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë "Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike" sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, e vlefshme deri në datën 27.10.2044 te shoqëria "Operatori i sistemit të shpërndarjes" sh.a. (OSSH sh.a.),

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën me nr. 7818 prot., datë 27.4.2018, ka përcjellë në ERE dokumentacionin për transferimin e licencave/licencimin e shoqërive të kontrolluara nga OSHEE sh.a.

- Me shkresën nr. 2 prot., datë 27.4.2018, "Operatori i sistemit të shpërndarjes" sh.a. (OSSH sh.a.) ka paraqitur në ERE kërkesën për transferimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëria "Operatori i sistemit të shpërndarjes" sh.a. (OSSH sh.a.).

- Shoqëria "Operatori i sistemit të shpërndarjes" sh.a. (OSSH sh.a.) është themeluar me statusin e shoqërisë aksionare në zbatim të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe urdhrit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 157 prot., datë 12.2.2018 të shoqërisë OSHEE sh.a., në cilësinë e aksionarit themelues. Data e themelimit është 28.3.2018.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 123, datë 4.6.2018, vendosi të fillojë procedurën për transferim e licencës së operimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë "Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike" sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, e vlefshme deri në datën 27.10.2044, te shoqëria "Operatori i sistemit të shpërndarjes" sh.a. (OSSH sh.a.).

- Në vijim të vendimmarrjes sipërcituar, ERE, në zbatim të nenit 10, pikat 8 dhe 9, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", me shkresën nr. 55/36 prot., datë 13.6.2018, bëri njoftimin në median e shkruar lidhur me kërkesën e bërë nga ky subjekt.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të rregullores sipërcituar, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me këtë aplikim.

- Shoqëria OSHEE sh.a. është licencuar në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, dhe mban licencën me nr. 250, seria P14SH.

- Me shkresën nr. 7818 prot., datë 27.4.2018, protokolluar në ERE, me nr. 355 prot., datë 30.4.2018, "Përcillet dokumentacioni ...", "Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike" (OSHEE sh.a.), ndër të tjera bën me dije, se" "Transferimi i personelit për këtë shoqëri, "Operatori i sistemit të shpërndarjes" (OSSH sh.a.), është në proces. Për rrjedhojë, lista e personelit sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, do të plotësohet në vijim".

- Me shkresën nr. 355/5 prot. datë 9.8.2018, ERE i ka kërkuar aplikuesit plotësim dokumentacioni dhe, me shkresën e datës 3.9.2018, protokolluar me tonën nr. 355/6 prot., "Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE sh.a.) ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar për llogari të shoqërisë "Operatori i sistemit të shpërndarjes" (OSSH sh.a.).

- Aplikimi i shoqërisë OSSH sh.a. plotëson kryesisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në bazë të nenit 10, pika 1 dhe 2, si dhe të nenit 17, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 17, pika 2, germa "a", formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, germat "a", "b" "c"): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 17, pika 2, germa "b", dokumentet juridike, administrative dhe pronësore, sipas nenit 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e"): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 17, pika 2, germa "c", dokumentet financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d"): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 2, germa "d" (çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike). Diagrami i sistemit të shpërndarjes që tregon elementet ekzistuese dhe ato të perspektives: subjekti nuk deklaron që ka modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike ose reflektim të ndryshimeve.

- Neni 17, pika 4, germa "a" (formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 4, germa "b" (një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 4, germa "c" (vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës): plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Transferimin e licencës në operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë "Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike" sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, te shoqëria "Operatori i sistemit të shpërndarjes" sh.a. (OSSH sh.a.), e vlefshme deri në datën 27.10.2044.

2. Shoqëria "Operatori i sistemit të shpërndarjes" sh.a. (OSSH sh.a.) të paraqesë në ERE listën e personelit, sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, pasi të përfundojë transferimi i personelit për këtë shoqëri, "Operatori i sistemit të shpërndarjes" sh.a. (OSSH sh.a.), nga struktura përkatëse.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 217, datë 11.10.2018

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "DANSKE COMMODITIES ALBANIA" SHPK PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ANA E ERE-s, PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË "DANSKE COMMODITIES A/S", ME 100% TË KUOTAVE TË KAPITALIT, NËPËRMJET SHITJES

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të pikës 5.2, të "Licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike" dhe të pikës 9.2, të "Licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike", si dhe të nenit 15, të "Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë "Danske Commodities Albania" sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, për ndryshimin e ortakut të vetëm të shoqërisë "Danske Commodities A/S", me 100% të kuotave të kapitalit, nëpërmjet shitjes,

konstatoi se:

- Shoqëria "Danske Commodities Albania" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 601 prot., datë 24.9.2018, ka përcjellë kërkesën për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, në lidhje me ndryshimin e ortakut të vetëm të shoqërisë "Danske Commodities A/S", me 100% të kuotave të kapitalit, nëpërmjet shitjes.

- Në këtë kërkesë, shoqëria "Danske Commodities Albania" sh.p.k., bën me dije ERE-n se ndodhet në fazën e ndryshimit të ortakut të vetëm të saj.

- Shoqëria "Danske Commodities Albania" sh.p.k. zotërohet 100% nga shoqëria "Danske Commodities A/S", e regjistruar në përputhje me legjislacionin e Danimarkës, me nr. 28113951 regjistrimi, me seli qendrore në Aarhus, Danimarkë.

- Sa më sipër, shoqëria "Danske Commodities Albania" sh.p.k. bën me dije ERE-n, se kanë filluar procedurat për blerjen e ortakut "Danske Commodities A/S", nga shoqëria norvegjeze multinacionale "Equinor", e cila operon në sektorin energjetik dhe atë të gazit natyror. Aktualisht, procesi i blerjes është në pritje të aprovimit nga Komisioni Evropian, si dhe nga autoritetet përkatëse të konkurrencës dhe finalizimi i tij pritet në fund të vitit.

- Shoqëria sjell në vëmendje se "Danske Commodities A/S" ose ortaku, do të vazhdojë të drejtohet nga i njëjti ekip menaxhues dhe do të vazhdojë të ketë selinë e saj në Aarhus, Danimarkë. Pas blerjes për një periudhë fillestare "Danske Commodities A/S" do të vazhdojë të operojë në një mënyrë të pavarur, duke ruajtur të pandryshuar emrin dhe markën e saj.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e ortakut të vetëm të shoqërisë "Danske Commodities A/S", me 100% të kuotave të kapitalit, nëpërmjet blerjes nga shoqëria norvegjeze "Equinor".

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 218, Datë 11.10.2018

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 133, DATË 7.6.2018, "MBI KËRKESËN E SHOQËRISË 'ÇAUSHI-ENERGJI' SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË "PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE" NR. 181, SERIA PV12K, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 122, DATË 29.8.2012"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 104, pika 4, germa "b"; të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96,

datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 133, datë 7.6.2018, "Mbi kërkesën e shoqërisë "Çaushi-Energji" sh.p.k., për modifikimin e licencës së "Prodhimit të energjisë elektrike" nr. 181, seria PV12K, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 122, datë 29.8.2012,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 133, datë 7.6.2018, pranoi kërkesën e shoqërisë "Çaushi-Energji" sh.p.k., për modifikimin e licencës me nr. 181, seria PV12K, për "Prodhimin e energjisë elektrike" nga HEC "Qafëzezë", me fuqi të instaluar 400 kw, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 122, datë 29.8.2012, me kushtin që brenda 3 muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi, të depozitojë në ERE lejen mjedisore dhe lejen e shfrytëzimit të ujërave, të lëshuara nga organet kompetente për fuqinë e instaluar 1450 kw.

- Po ashtu, në pikën 2, të vendimit sipërcituar është përcaktuar, se: "Në rastin e mospërmbushjes së këtij kushti nga ana e subjektit, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi".

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE ka përcjellë pranë subjektit shkresën nr. 312/1 prot., datë 18.6.2018, "Njoftim vendimi", me anë të së cilës ka bërë më dije subjektin për vendimmarrjen me kusht të Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e tij për modifikimin e licencës.

- Në vijim të kësaj korrespondence, ERE, me shkresën nr. 312/2 prot., datë 28.6.2018, ka dërguar pranë subjektit "Çaushi-Energji" sh.p.k. vendimin nr. 133, datë 7.6.2018, sipërcituar.

- Po ashtu, ERE, me shkresën nr. 312/3 prot., datë 24.8.2018, ka përcjellë pranë subjektit "Çaushi-Energji" sh.p.k. një "Kujtesë", me anë të së cilës ka kujtuar subjektin se afati i përmbushjes së kushtit në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 133, datë 7.6.2018, përfundon në datën 28.9.2018 dhe, gjithashtu, detyrimin e subjektit për të depozituar në ERE, lejen mjedisore dhe lejen e shfrytëzimit të ujërave, të lëshuara nga organet kompetente për fuqinë e instaluar 1450 kw.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 133, datë 7.6.2018, nga ana e subjektit "Çaushi-Energji" sh.p.k., është depozituar shkresa e protokolluar në ERE me nr. 312/4 prot., datë 24.9.2018, me anë të së cilës ky subjekt ka dërguar lejen e përdorimit të rezervave ujore nr. 12, datë 4.011.2009 e cila ka përfunduar vlefshmërinë e saj në datën 4.11.2014 dhe ka deklaruar se ka bërë aplikim për rinovimin e saj me shkresën nr. 1017 prot., datë 20.9.2018, pranë Këshilli i Basenit Ujor Seman, ka likuiduar dhe tarifat përkatëse dhe pret miratimin nga ky Këshill.

- Subjekti "Çaushi-Energji" sh.p.k. ka deklaruar në shkresën e tij se ka edhe një leje mjedisore të miratuar me vendimin nr. 22, datë 24.8.2010 të Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave, e cila është e vlefshme dhe për periudhën aktuale, pasi sikurse edhe vetë leja citon në pikë 6 të saj, ajo bëhet e vlefshme pasi veprimtaria licencohet nga institucioni përkatës. Vlen të theksojmë, se leja mjedisore, në pjesën "Specifikime teknike" pasqyron fuqinë prej 1000 kw, ndërkohë që fuqia që kërkon të ndryshojë subjekti "Çaushi-Energji" sh.p.k., shkon në 1450 kw.

- Shpjegimet e dhëna dhe dokumentet e paraqitura nga ana e subjektit, nuk janë të mjaftueshme dhe konsiderohen një mungesë dokumentacioni thelbësor për vendimmarrjen finale të Bordit të ERE-s mbi këtë modifikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 133, datë 7.6.2018, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Çaushi-Energji' sh.p.k. për modifikimin e licencës së "Prodhimit të energjisë elektrike" nr. 181, seria PV12K, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 122, datë 29.8.2012.

2. Refuzimin e kërkesës së shoqërisë "Çaushi-Energji" sh.p.k., për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike me nr. 181, seria PV12K, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 122, datë 29.8.2012.

3. Shoqëria "Çaushi-Energji" sh.p.k. të depozitojë në ERE, brenda 10 ditëve nga marrja dijeni e vendimit, kartonin e licencës së lëshuar me kusht.

4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë OSHEE sh.a. dhe MIE-n për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 219, datë 11.10.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "DON-UCD" SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa "d", të nenit 5, pika 1, germa "d" dhe të nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 11.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë "DON-UCD" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 212, datë 27.9.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "DON-UCD" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën me nr. 55/59 prot., datë 28.9.2018, ka bërë njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me këtë aplikim.

- Po ashtu, me shkresën nr. 592/1 prot., datë 28.9.2018, ERE ka përcjellë pranë subjektit njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës, si dhe kërkesën për plotësim dokumentacioni, e cila kishte të bënte me strukturën e ndërtimit të shoqërisë (neni 9, pika 2, germa "e") të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

- Sa më sipër, shoqëria "DON-UCD" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 592/2, datë 4.10.2018, ka plotësuar dokumentacionin e munguar në aplikimin e tij.

- Aplikimi i shoqërisë "DON-UCD" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7): plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "DON-UCD" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesi për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 220, datë 11.10.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ENER TRADE" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "d" të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa "e"; të nenit 5, pika 1, germa "e" dhe të nenit 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016;

të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Ener Trade" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 628 prot., datë 3.10.2018, shoqëria "Ener Trade" sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë "Ener Trade" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "e"): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat "b" dhe "c"): plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa "d" (vërtetim nga gjykata dhe prokuroria), do t'i kërkohet subjektit, që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Ener Trade" sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 221, datë 11.10.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ENER TRADE" SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa "d", nenit 5, pika 1, germa "d", dhe nenit 10, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 11.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Ener Trade" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 628 prot., datë 3.10.2018, shoqëria "Ener Trade" sh.p.k. ka paraqitur në ERE kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit e energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë "Ener Trade" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a, "b", "c", "e"): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7 dhe 4.7.1): plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa "d" (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata), do t'i kërkohet subjektit që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Ener Trade" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 223, datë 16.10.2018

MBI MIRATIMIN E "KËRKESAVE MINIMALE PËR ZYRTARIN E PËRPUTHSHMËRISË, KRITERET PROFESIONALE, SI DHE KRITERET E TJERA PËRZGJEDHËSE" DHE MIRATIMIN PARAPRAK TË ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË OST TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", nenit 47 të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, "Mbi certifikimin e shoqërisë operatori i kombinuar i gazit natyror 'Albgaz' sh.a." dhe nenit 15, të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi miratimin e "Kërkesave minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale, si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse" dhe miratimin paraprak të zyrtarit të përputhshmërisë të OST-së të gazit natyror,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, ka certifikuar "Operatorin e kombinuar të gazit natyror" ("Albgaz" sh.a.).

- Shoqëria "Albgaz" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 565 prot., datë 3.9.2018, ka paraqitur kërkesën për miratimin paraprak të kandidaturës së zyrtarit të përputhshmërisë.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 207, datë 27.9.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Albgaz" sh.a. mbi miratimin paraprak të zyrtarit të përputhshmërisë së OST-së të gazit natyror.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 626 prot., datë 3.10.2018, ka përcjellë shkresën "Marrje mendimi" pranë MIE-s dhe Autoritetit të Konkurrencës, për dijeni "Albgaz" sh.a., me anë të së cilës ka ftuar institucionet sipërpërmendur të shprehin opinionet apo komentet e tyre mbi këtë vendimmarrje. Vlen të theksojmë se deri më sot nuk ka mbërritur asnjë objeksion apo koment nga palët sipërcituar.

- Gjithashtu, ERE, me shkresën nr. 623 prot., datë 2.10.2018, i është drejtuar shoqërisë "Albgaz" sh.a. dhe MIE-s, duke i bërë me dije vendimin e ERE-s për fillimin e procedurës dhe i ka kërkuar të paraqesë për miratim në ERE, "Kërkesat minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale, si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse", sipas detyrimit që buron nga "Programi i përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror", të miratuar nga me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.5.2017.

- Sa më sipër, shoqëria "Albgaz" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 565/3 prot., datë 10.10.2018, ka përcjellë për miratim "Kërkesat minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale, si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse", si më poshtë:

Kërkesat minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale, si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse

Kriteret profesionale:

- Personi fizik të zotërojë diplomë të nivelit master shkencor në shkencat juridike/ekonomike; pas një diplome të nivelit *Bachelor* në shkencat juridike/ekonomike;

- Personi fizik/juridik, me përvojë prej të paktën 5 vjet në shërbime ligjore/ekonomike.

Kërkesat përzgjedhëse:

- Personi/kompania duhet të ketë aftësi analizuese në çështjet rregullatore, me fokus mbikëqyrjen e zbatimit të kërkesave ligjore mbi transparencën, përputhshmërinë e procedurave dhe praktikave konform rregulloreve përkatëse;

- Personi/kompania nuk duhet të ketë një kontratë shërbimi aktuale me ndonjë subjekt tjetër të angazhuar në sektorin e gazit, përveç operatorit të kombinuar të "Albgaz" sh.a.;

- Personi kandidat nuk duhet të kryejë asnjë detyrë tjetër profesionale dhe nuk duhet të lejohet që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të kryejë ndonjë funksion tjetër apo të marrë pjesë në biznes ose të jetë partner biznesi me ndonjë pjesë të kompanisë vertikalisht të integruar ose me shumicën e aksioneve të saj ose me çdo kompani të lidhur në aktivitetin e gazit natyror, përveç transmetimit të gazit natyror.

Kriteret kualifikuese:

- Personi kandidat: Dëshmi penaliteti, vërtetim procedimi gjyqësor:

- Personi kandidat: Kontribute sociale të papaguara, taksa dhe tatime të palikuiduara;

- Kompania: Proces falimentimi ose likuidimi.

- ERE ka kompetencë të miratojë programin e përputhshmërisë të propozuar nga OST-ja e gazit natyror, në bazë të nenit 47, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

- OST-ja e gazit natyror, nëpërmjet organeve të saj drejtuese ka të drejtë të miratojë zyrtarin e përputhshmërisë, pas miratimit paraprak nga ERE, në bazë të nenit 47, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

- ERE ka kompetencën për të miratuar kriteret dhe detyrat për pozicionin e zyrtarit të përputhshmërisë, në bazë të nenit 47, pika 3, të ligjit nr. 102/2015, "për sektorin e gazit natyror".

- Kushtet e kontratës së zyrtarit të pajtueshmërisë janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimmarrjet e ERE-s, në lidhje me Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror.

- Kontrata e zyrtarit të pajtueshmërisë ka listuar kushtet që duhet të përmbushë zyrtari i pajtueshmërisë dhe që nënshkruhen pas miratimit në ERE të zyrtarit të përputhshmërisë.

- Vendimi i Bordit të ERE-s është objekt rishikimi me kërkesë të palëve të interesuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë "Kërkesat minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale, si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse".

2. Të miratojë paraprakisht zyrtarin e përputhshmërisë së OST-së të gazit natyror, z. Elvis Ponari.

3. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë "Albgaz" sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 694 (1667), datë 26.9.2018, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Ferdinant Lenë Mihaj, i datëlindjes 14.4.1954, si dhe caktimin e kërkuesit Petrit Vasil Lenë Mihaj, i datëlindjes 1.1.1941, si kujdestar të shtetasit Ferdinant Lenë Mihaj për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKESË

Shtetasja Hane Belegu, e datëlindjes 7.3.1964, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, shpalljen të vdekur të shtetasit Kujtim Belegu, i datëlindjes 12.7.1960.

KËRKUES
Hane Belegu

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 308 lekë